



12% më shumë
buxhet për bujqësinë,
Qeveria mbështetjet
e drejtpërdrejtë për
fermerët

Faqe 4



Ministria Krifca:
Peshkimi, ndër sektorët
më vitalë të ekonomisë
shqiptare, po mbrojmë
flotën detare nga
çmimi naftës

Faqe 7



Aspektet cilësore të
Punës në Agrobiznes,
ICT & Turizëm, rritje
të qëndrueshme të
kompanive private në
krijimin e mundësive
të punësimit

Faqe 2



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 449
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

15-ditëshi i parë i muajit nëntor 2022

KRYEMINISTRI RAMA: SUPERTAKSIM PËR ATA FERMERË QË I LËNË TOKAT DJERRË

KRYETARI I KASH, RRAPAJ: DUHEN GJETUR ZGJIDHJE E PËRDORUR NJËKOHËSISHT DISA INSTRUMENTE NXITËS, PËR TË NDIHMUAR FERMERIN DHE JO PËR TA NDËSHKUAR ATË QË TË MOS E LËRË TOKËN PA PUNUAR

Supertaksimi i tokës së lënë djerrë ka qenë dhe është një nga temat më të diskutuara ditët e fundit, pas deklaratës së bërë nga kryeministri Rama. Kjo deklaratë ka shkaktuar mjaft debate tek fermerët dhe në media. Por a është e vetmja zgjidhje dhe cilat janë problemet që sjell supertaksa? Gjithashtu a mund të gjendet një zgjidhje konsensuale? Për këtë temë kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj ka dhënë një intervistë për TV SCAN

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Platformë me njoftime për të gjitha vendet e lira të punës



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

SIPËRMARRJE



Çfarë sfidash kanë gratë në zonat rurale?

Faqe 2



Të punojmë tokën apo të paguajmë taksën?

TË PUNOJMË TOKËN APO TË PAGUAJMË TAKSËN?
RRAPAJ: DUHET TË PUNOHET TOKA DJERRË, JO TË NDËSHKOHET FERMERI

ZHVILLIM RURAL



Industri e lehtë përpunuese për produktet e ekselencës dibrane

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- Përdorimi i qëndrueshëm i kullotave për ushqimin e blegtorisë Fq.11
- Sëmundjet kryesore të ullirit Fq.12
- Domatet më të njohura në Botë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13


Ministria Krifca:
Të investohet në rritjen e kapaciteteve të ruajtjes frigoriferike me panele diellore



Faqe 4

KËSHILLIM KARIERE

Sondazhi nxjerr perspektivën e studentëve mbi arsimin profesional në Shqipëri



Faqe 2

TEMA TË DITËS

Rama: 500 investime të reja në bujqësi, mbi 180 milionë dollarë mbështetje

Shqipëria është vendi i parë në rajon për sa i takon thithjes së fondeve nga Bashkimi Eu-

dit në rajon për këtë tregues. Kështu u shpreh Kryeministri Edi Rama në një takim me

aktualisht janë më shumë sesa 500 investime të reja në bujqësi, që e kanë kaluar shifrën 180 milionë dollarë.

“Janë të gjitha në territor dhe i shërbejnë zhvillimit të këtij sektori”, tha ai.

Kryeministri informoi se “me programin e ri kemi një tjetër kapacitet financiar në dispozicion prej afro 150 milionë euro, gjë që do të na bëjë të mundur të mbështesim edhe më shumë akoma për të shtuar pikat e grumbullimit dhe agropëpunimit”.

“Kapacitetet frigoriferike do të rrisin vlerën e produkteve dhe vendimmarrja për të nxjerrë produktet në treg do të jetë e pavarur nga kushtet dhe pamundësia për t’i mbajtur”, tha ai.



ropian për bujqësinë, ndërkohë që më parë ka qenë vendi i fun-

fermerët në Dvoran të Korçës. Kryeministri u shpreh se

12% më shumë buxhet për bujqësinë, Krifca: Mbështetje e drejtpërdrejtë për fermerët

Buxheti 2023 për bujqësinë ka në fokus mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve për rritjen e prodhimit, eksporteve, sigurinë ushqimore dhe fuqizimin e ekonomisë rurale.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca gjatë prezantimit pasditen e së martës, në Komisionin e Kuvendit, të projektbuxhetit 2023 për Bujqësinë tha se “buxheti për bujqësinë arrin në 14.2 miliardë lekë me një rritje 12% krahasuar me atë të këtij viti”.

madh në mbështetje të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ai adreson mbështetje për 7 programe”, tha ministrja.

Gjithashtu theksoi Krifca, buxheti për vitin që vjen, garanton mbështetje për rritjen e sigurisë ushqimore, qëndrueshmërinë e turizmit rural, si dhe digjitalizimin dhe inovacionin.

“Është një buxhet që kërkon punë dhe puna është e përbashkët”, u shpreh ministrja teksa evidentoi se buxheti 2023 mbështet skemën

kombëtare të fermerëve, me një fond total 1.97 miliardë lekë. Po ashtu, garantohej mbështetje për skemën e subvencionimit të naftës, me një fond total 1.62 miliardë lekë, ku parashikohet të rritet numri i përfituesve. Financohet garantinë dhe Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Menaxhimin e Infrastrukturas së Ujitjes dhe Kullimit, me një fond total prej 240.4 milionë lekë dhe mbështet Peshkimin me një buxhet prej 403 milionë lekësh”.

Fermerët duan të braktisin tokat - Rritja e kostos së mbjelljeve po i falimenton

Bilbil dhe Ilirjana Tabaku janë një çift bashkëshortësh

kam menduar dhe ta braktis këtë punë dhe nëse vazhdon

kjo situatë do ta braktisin si serën ashtu dhe vendin duke u larguar drejt vendeve të BE”, tha fermeri.

“Është një punë e vështirë por s’kemi ç’të bëjmë pasi këtë kemi të vetmen mundësi ekonomike”, tha fermerja.

Zona e Darsis ku ndodhet fshati Çanakaj është një nga zonat më prodhuese por politikë e ndjekura në fushën e bujqësisë nuk kanë rezultuar frytëdhënëse për banorët duke bërë që shumica e fermerëve ta braktisin jo vetëm bujqësinë, por edhe vendin.



BILBIL TABAKU - FERMER

nga Çanakaj në Lushnjë, që prej më shumë se 15 vitesh merren me kultivimin e perimeve në sera diellore.

Për çiftin e fermerëve ky vit nuk quhet i suksesshëm edhe pse domatja e cila ata kanë prodhuar shitet me çmim 80 lekë kilogrami. Çmimet e larta të inputeve bujqësore, plehrat dhe rritja e çmimit të krahut të punës nuk e mbulon koston.

“Jam i detyruar të punoj në sera se s’kam ku të shkoj në këtë moshë, por shpesh herë



ILIRJANA TABAKU - FERMIERE

Krifca: Të investohet në rritjen e kapaciteteve të ruajtjes frigoriferike me panele diellore

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca deklaroi se përmes skemave të drejtpërdrejta të mbështetjes në bujqësi, fermerët shqiptarë kanë përfutur gjatë këtij viti, 49 milionë dollarë.

Vetëm nga skema e mbështetjes me “naftë pa taksë” kanë përfutur këtë 34 200 fermerë në rang vendi, ndërsa në Korçë janë 8240 fermerë, përfutues, ose 3500 më shumë se vitin e kaluar.

Krifca vuri theksin në nevojën e ngritjes së linjave të përpunimit.

“Kjo është një zonë prodhuese e jashtëzakonshme e drufrutorëve. Por këto prodhime dalin në treg në sezonin e tyre. Por që të kenë një vlerë të shtuar kanë nevojë për trajtim të mëtejshëm. Në Korçë janë 53 pika grumbullimi. Vetëm 3 prej tyre kanë sot temperaturë të kontrolluar gjithëvjetore. Është e pamundur të ruhen e të jenë në treg jashtë sezonit me çmime të larta, për të marrë fitim”, tha ministrja.

Ndaj, shtoi ajo, duhet të investohet në rritjen e kapac-

iteteve të ruajtjes frigoriferike me panele diellore. Ministrja tha se instalimi i paneleve diellore mbështetet nga programet e IPARD-it.

Krifca solli shembullin e

investojmë në mënyrë të mençur, në përputhje me nevojat e tregut të eksportit që sa vjen e është në rritje”, tha ajo.

Ministrja Krifca bëri të ditur se programet e mbështetjes së



një fermeri, i cili ka të instaluar panelet diellore në çatinë e pikës së tij të grumbullimit, që i sjell kursim deri në 80 % të kostos.

“Me instalimin e paneleve diellore mbi çati, ky fermer kursen gati 80 % të kostove të prodhimit. Në një ditë si kjo, kur energjia është shtrenjtuar është një zgjidhje e zgjuar. Ne duhet të

fermerëve kanë bërë të mundur rritjen e eksporteve

Ministrja vuri në dukje se përmes programeve të mbështetjes për bujqësinë kanë përfutur edhe 5 pika agroturizmi, që sot ofrojnë standarde bashkëkohore për vizitorët dhe janë model për kushtet që ofrojnë.

“Derë më derë” për regjistrimin e fermerëve të Tiranës - Deklarim për produktet bujqësore dhe blegtorale, sipërfaqet e tokave dhe fitimeve

Fermerët e 13 njësi administrative të Tiranës do t’i nënshetrohen një procesi intervistimi për tokat të cilat përdorin për aktivitetin e tyre. Në këtë formular

burime apo jo. Përsa i përket blegtorisë fermerët duhet të deklarojnë numrin e gjedhëve dhe shpendëve që kanë por dhe çmimin e shitjes pas therjes së

jqësor por dhe marrja e kredive për investime në fermë renditen si pyetje për t’u përgjigjur.

Pas marrjes së të dhënave nga punonjësit në terren, 2 punonjës për secilën njësi administrative, do të ngrihet një sistem elektronik për analizimin dhe ruajtjen e tyre.

Për realizimin e këtij projekti Bashkia Tiranë ka hapur tenderin me vlerë 16.6 milionë lekë pa Tvsh. Ky tender duket se vjen pas paralajmërimit të kryeministrit Edi Rama një ditë më parë kundrejt fermerëve për punimin e tokave përndryshe do të taksohen më shumë.

Pas procesit të mbledhjes së të dhënave nga punonjësit e terrenit, Sektori i Zhvillimit Ekonomik Rural, do të verifikoj, përpunoj, analizoj dhe gjeneroj raporte automatike të detajuara në funksion të objektivave.



i cili do të realizohet nga Bashkia Tiranë fermerët do të japin të dhëna për tokat në lidhje me sipërfaqen që kanë në pronësi apo që kanë marrë me qera, zonën në të cilën jetojnë. Pyetjet përfshijnë sipërfaqen në pronësi, sipërfaqen marrë me qera ose forma të tjera përdorimi dhe sipërfaqen e dhënë me qera ose forma të tjera përdorimi.

Nëse tokat janë të punuara fermerët duhet të deklarojnë se çfarë kulturash bujqësore kanë mbjellur duke bërë një bilanc të bimëve, perimeve, pemëve frutore, deklarim I plehrave organik dhe kimik të përdorur, deklarim të pesticideve të blera dhe periudhën që i kanë mbjellë dhe përdorur.

Gjithashtu formulari rendit pyetje edhe për sistemin e ujitjes, nëse fermerët kanë

tyre. Për 12 muajt e fundit për produktet e bulmetit, fermerët duhet të deklarojnë fitimet.



Për ata fermerë të cilët kanë punonjës të punësuar duhet të deklarojnë moshën dhe arsimimin e tyre. Sigurimi i prodhimit bu-

Gjithashtu bazuar në analizën e kryer do të hartohen politika, programe në mbështetje të grupeve të interesit.

Shqipëria nis dialogët kombëtarë për projektin e Sistemeve të Qëndrueshme të Ushqimit në Mesdhe

FAO në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë organizon konferencën e parë në nivel kombëtar për Sistemet e Qëndrueshme Ushqimore në Mesdhe, (SFS-MED) një nismë shumë palëshe, një komponent thelbësor i projektit ambicioz që synon të angazhojë të gjithë partnerët në nivel kombëtar dhe vendor në zbatimin e qasjeve të reja dhe zgjidhjeve konkrete për transformimin e sistemeve ushqimore në vend. Aktiviteti i sotëm është në vijim të rrugëtimit të dalë nga Dialogët Kombëtarë për Sistemet e Qëndrueshme Ushqimore në Shqipëri, të Samitit të OKB-së për Sistemet Ushqimore në vitin 2021, drejtuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe mbështetur nga OKB.

"Ne kemi nevojë për diversifikimin e ekonomisë rurale, përmirësimin e sistemeve të zinxhirit të vlerës ushqimore, rritjen e eksporteve duke arritur tregje të reja në gjithë botën. Në këtë kontekst, Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm dhe eksportet bujqësore janë rritur me 27% në tre vitet e fundit duke futur etiketën "Made in Albania", tha Ami Çarçani, Drejtor në Drejtorinë

hartimin dhe emiratimin e strategjive dhe politikave në përputhje me kapitujt e bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe peshkimin të Bashkimit Evropian,



platforma e Sistemeve të Qëndrueshme Ushqimore në Mesdhe luan një rol kyç në mbështetjen e transformimit të sistemeve ushqimore në rajon.

shtoi përfaqësuesja e Ministrisë së Bujqësisë.

Gjatë fjalës së tij, Përfaqësuesi i FAO-s për Shqipërinë, Raimund Jehle theksoi se

"Projekti ofron një forum për dialog dhe bashkëpunim pasi përfshin shumë aktorë, duke forcuar rrjetin për shkëmbimin e njohurive, si dhe ngritjen e

Mesdhe", u shpreh Raimund Jehle, Përfaqësuesi i FAO-s për Shqipërinë.

E ftuar në takim, Koordinatorja e Përhershme e OKB-së në Shqipëri, Fiona McCluney, shprehu angazhimin e ekipit të OKB-së në mënyrë aktive mbi procesin e Samitit të Sistemeve Ushqimore të Kombeve të Bashkuara duke mbështetur zbatimin e Rrugës së Sistemit Kombëtar të Ushqimit në Shqipëri, me aktivitete të rëndësishme të udhëhequra nga FAO, si organizimi i dialogut kombëtar dhe lokal vitin e kaluar. "Organizata e Kombeve të Bashkuara mbështet bashkëpunimin shumë sektorial dhe koherencën e politikave. Transformimi i sistemit ushqimor për të arritur rezultate të përmirësuar të qëndrueshmërisë dhe ushqyerjes për të gjithë ka nevojë për një qasje holistike, duke krijuar sinergji midis ndërhyrjeve të ndryshme sektoriale, tha Fiona McCluney, Koordinatorja e Përhershme e OKB-së për Shqipërinë.

Dialogët kombëtarë kanë në fokus identifikimin e elementeve thelbësore për të mundësuar Rrugën Kombëtare të Sistemeve të Qëndrueshme Ushqimore në Mesdhe, ndjekur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke përfshirë Strategjinë e re për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin, Politika Kombëtare të Sigurisë Ushqimore, strategjia e Turizmit Rural, Planin 10-vjeçar për Përdorim të Qëndrueshëm të Pesticideve të cilat janë në proces zhvillimi për tu zbatuar nga aktorët. Zbatim i projektit në nivel kombëtar në kuadrin e Platformës SFS-MED, një iniciativë shumë palëshe për Sistemet e Qëndrueshme Ushqimore në Mesdhe synon të lehtësojë integrimin e mëtejshëm, forcimin dhe shkallëzimin e qasjes së kombinuar të sistemeve ushqimore. FAO do të ofrojë mbështetje për dialogët e nivelit lokal që do të kryhen në kuadrin e Platformës për Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit në Mesdhe, duke angazhuar qeveri të lokale, komunitetet lokale dhe bashkitë.

Korça, 60% të fondeve nga programet e mbështetjes në bujqësi

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, e cilësoi Ersekën një pol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare bujqësore, që falë programeve të mbështetjes nga qeveria po kontribuon në rritjen e ekonomisë, krijimin e markës bujqësore kolonjare dhe nxitjen e angazhimit të të rinjve në bujqësi.

Duke marrë fjalën në takimin që zhvilloi Kryeministri Edi Rama në Mollas, Ersekë me fermerët, blegtorët e

alitet që janë edhe një nevojë për t'u përgjigjur një situatë të pazakontë që po ndodh në Ukrainë nga lufta e Putinit, e cila ka rritur çmimet globale, ka ndërprerë zinxhirin e furnizimit me inputet bujqësore, ka rritur çmimin e naftës, çka ju e ndieni në punët e përditshme. Pra ka nevojë për një dialog, me ne si politikbërës dhe me ju që prodhoni, për të gjetur zgjidhje të përbashkëta dhe në vijimësi", tha ministrja Krifca.

Ministrja u ndal në

më përpara, por asnjë herë nuk është vonë, e ndaj jemi këtu për t'i dhënë zgjidhje problematikave", theksoi ministrja Krifca.

Referuar statistikave, ministrja tha se, gjatë këtij viti që ka qenë sfidues për bujqësinë, qeveria i është përgjigjur duke shtuar fondet dhe masat në mbështetje të fermerëve.

"Mbështetja për naftën është dyfishuar, ndërsa është trefishuar numri i aplikantëve përfitues në këtë skemë krahasuar me një vit më parë. Në Kolojë kemi 800 fermerë përfitues nga skema e naftës pa taksa për bujqësinë. Ndërsa 250 fermerë kanë përfituar financim nga skema e bletarisë dhe blegtorisë, që janë degë prioritare këtu, për të vijuar me mbështetjen në agroturizëm. Po aplikojmë këtë vit masën e mbështetjes për grurin, me një fond prej 5 milionë euro të vënë në dispozicion nga qeveria, për fermerët që mbjellin grurë. Janë 50 fermerë këtu që kanë përfunduar verifikimin dhe janë gati të marrin mbështetjen financiare dhe kështu do të vijojmë me të gjithë fermerët që janë pjesë e këtij aplikimi", deklaroi ministrja, teksa shprehu gatishmërinë se qeveria do të vijojë me mbështetjen edhe për pikat e grumbullimit.

"Krijimi rrjetit të pikave të grumbullimit dhe përpunimit, do të krijojë pasaportën e produkteve kolonjare që janë mjaft të kërkuara nga konsumatorët vendas dhe të huaj. Është e rëndësishme, që ju duhet të

(Vijon në faqen 10)

Ministrja e Bujqësisë: Industri e lehtë përpunuese për produktet e ekselencës dibrane

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca e cilësoi Dibrën ekselencë me vete në bujqësi dhe agroturizëm, ndërkohë që bëri të ditur se orientimi është drejt krijimit të një industrie të lehtë përpunuese që do u shtojë vlerën.

E pranishme në turin e takimeve që zhvilloi Kryeministri Edi Rama në Peshkopë, me fermerë dhe banorë të zonë, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca informoi se në Dibër prodhohen rreth 17 mijë tonë perime të fushës dhe kultivohen 1 milion drunj frutorë, që plotësojnë një pjesë të madhe të nevojave të tregut tonë dhe janë mjaft të kërkuara për cilësinë, shijen e veçantë, ndërkohë që sjellin të ardhura pasi shiten me çmime mjaft të mira.

"Ajo industria e lehtë përpunuese e produkteve të ekselencës dibrane duhet të ndodhë këtu dhe bashkia ka një rol të madh. Ne jemi këtu për t'ju mbështetur, kjo mbështetje është vënë në funksion përmes shumë programeve. Këtë vit është buxheti më i madh i vënë në dispozicion të bujqësisë dhe në vlerë edhe në numër përfituesish është dyfishuar numri i fermerëve në Dibër", u shpreh Krifca.

"Vij në shumë emocion dhe kënaqësi në Dibër se është edhe vendi i të parëve të mi. Shumë prej jush i kam takuar edhe më parë dhe sot folëm edhe më në detaje për disa problematika me të cilat ndeshet ky sektor, pasi dhe ne nuk kemi frikë nga problemet, ne përballemi dhe përpiqemi të gjejmë zgjidhje kur ato ndodhin", tha Krifca.

Ministrja solli në vëmendje mollët që janë vërtetë traditë e

kësaj zone, por për të cilat, siç tha ajo, "kemi nevojë të përmirësojmë praktikën e kultivimit".

"Kemi shumë shembuj në Shqipëri, të atyre pemëtore që janë fantastike dhe janë mbështetur me njohuri edhe

përfunduar mbështetje për një stallë por tani po e zgjeron investimin në agroturizëm", u shpreh ministrja, teksa tha se "në blegtori shohim interes të fermerëve për të shtuar tufat blegtorale por edhe për pika



nga prodhuesit më të mirë botërorë, nëpërmjet projekteve të shumta të vëna në dispozicion nga qeveria, por ne në fakt na duhet të ecim më tej në këtë drejtim", theksoi Krifca.

Sipas saj, atë që ka bërë QTB-ja e Shkodrës, për drithërat, ku nëpërmjet eksperiencës së vet dhe transferimit të teknologjive ka ndihmuar fermerët të përmirësojnë rendimentet e misrit dhe të grurit, duhet bërë edhe për drufrutorët.

"Me mbështetjen që kemi dhënë kemi mundur të ndihmojmë në shtimin e parcelave të reja me pemëtore. Në Dibër janë 2 milionë euro të vëna në dispozicion nga IPARD për rreth 13 investime, nga të cilat 7 janë në agroturizëm. Ju e keni shfrytëzuar këtë mbështetje duke ndjekur shembullin sesi funksionojnë këto modele siç është rasti i dikujt këtu që ka

përpunimi". Krifca deklaroi se, "nëpërmjet mbështetjes kemi krijuar një orientim, për të lidhur gjithë zinxhirin e vlerës nga prodhimi në përpunim dhe në treg".

Ministrja solli në vëmendje ecurinë pozitive në drejtim të investimeve për ndërtimin e tregjeve bujqësore. "Ne e nisëm në fillim me ndërtimin e tregut bujqësor në Bulqizë dhe do të ngremë në Dibër një treg, pikë grumbullimi, që t'i shtojmë vlerë produkteve bujqësore duke i shitur ato edhe të përpunuara", theksoi ajo.

Ministrja theksoi se sot ka mbështetje shumë më tepër se më parë, teksa vuri në dukje se ndikim kanë dhënë investimet në infrastrukturë që i kanë sjellë prodhimet më shpejt në treg, në ujtitje dhe vepra të tjera infrastrukturore.



njerëzit e punës të kësaj zone, ministrja Krifca u shpreh se "Kolonja është një vend që të ofron shumë bukuri natyrore dhe vlera të mëdha, por vlera më kryesore janë fermerët të cilët nuk lënë asnjë pjesë toke pa punuar. E kjo shihet përgjatë gjithë rrugës që përshkon për të ardhur këtu".

"Ne e kemi filluar këtë dialog mbarëkombëtar dhe po ecim në një maratonë diskutimesh me Kryeministrin Edi Rama, pasi duam të diskutojmë problematikën e aktu-

përthithjen e fondeve në investime që i shërbejnë komunitetit të fermerëve.

"Ju keni nevojë për një pikë frigoriferike dhe mua më erdhi keq që nuk kemi mundur ta zgjidhim këtë më përpara. Pasi qarku Korçë, është një nga qarqet flamurtar, për sa i takon përthithjes së fondeve, si nga Skema Kombëtare apo programi IPARD. Korça shënon 60% të përthithjes së fondeve. Ndaj nëse këtu ishte dashur që ne të kishim një pikë grumbullimi, do ta kishim zgjidhur këtë edhe



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

